



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 631/5 Prot.

Tiranë, më 20/09/2016

V E N D I M

Nr.109, Datë 20.09.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A LEZHË “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financimet e Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA Lezhë për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më datë 30.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi

-Në strukturën organizative të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë nuk është ngritur njësi e auditit të brendshëm, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 345, datë 01.06.2004, seksioni II, pika 8 ku përcaktohet se shoqëritë anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind detyrohen të ngrenë strukturën e auditimit të brendshëm sipas kriterëve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 11-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës të merren masa që në strukturën organizative të Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, të organizohet dhe të funksionojë njësi e auditit të brendshëm, në zbatim të VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar me VKM nr.353, datë 11.05.2016.

Në vazhdimësi

2.Gjetje nga auditimi

-Për periudhën objekt auditimi u konstatua se me vendim të Këshillit Mbikëqyrës në fund të vitit, punonjësit e shoqërisë kanë përfituar shpërblim në vlerën 10,000 lekë/secili. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës, janë marrë në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave” për arsye se shpërblimi është përfituar para daljes së rezultatit financiar por edhe se shoqëria “UK Lezhë” SH.A subvencionet nga shteti për pagesën e energjisë elektrike dhe për rrjedhojë nuk mund të akordojë shpërblim për punonjësit. Në total shuma e shpërblimit në vlerën **3,184,999 lekë**, ka sjellë efekt negativ për buxhetin e shoqërisë. Konkretisht:

-Këshilli Mbikëqyrës me vendimet nr.9, datë 19.12.2012 dhe nr.4, datë 24.12.2013 ka miratuar dhënien e shpërblimeve ***në shumat 794,167 lekë për vitin 2012 dhe 782,499 lekë për vitin 2013.***

-Këshilli Mbikëqyrës me vendimet nr.5, datë 15.12.2014 dhe nr.5, datë 18.12.2015 ka miratuar dhënien e shpërblimeve ***në shumat 773,335 lekë për vitin 2014 dhe 834,998 lekë për vitin 2015*** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 11-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

*-Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i Shoqërisë, të rishqyrtojnë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitet 2012-2015 në vlerën **3,184,999 lekë**, vlerë e cila për buxhetin e shoqërisë përbën efekt financiar negativ, duke analizuar rezultatit financiar faktik vjetor në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve” si dhe të evidentohen përgjegjësitë dhe në të ardhmen, vendimet për dhënien e*

shpërblimeve, të merren pas daljes së rezultatit financiar vjetor për të mënjeluar shpenzimet përtej mundësive të shoqërisë.

Në vazhdimësi

3.Gjetje nga auditimi

-Nga analizimi i treguesve ekonomiko-financiar për vitet 2012-2015 rezulton se shoqëria, me gjithë përmirësimet, nuk i ka realizuar këta tregues. “Ujësjetillës Kanalizime” SH.A Lezhë, nuk e ka arritur objektivin e saj përse i përket vjeljes së të ardhurave dhe kjo vjen nga mos-arkëtimi i borxhit nga abonentët debitorë si dhe nga sasia e madhe e ujit që humbet në rrjet për shkaqe teknike dhe ekonomike. Treguesit mesatarë të shitjes dhe arkëtimin të faturave të ujit të pijshëm, janë në nivelet e 35-39%, nivele performance këto shumë të ulta, të cilat vijnë nga humbjet në rrjet dhe arkëtimet në nivele jo të kënaqshme.

Shpenzimet janë realizuar në masën 75-78% nga ato të parashikuara. Nuk janë realizuar kryesisht shpenzimet për paga shpërblime në masën 33-38% nga ato të parashikuara si rezultat i pamundësisë financiare për të plotësuar organikën sipas strukturës së miratuar, shpenzimet për energjinë elektrike në masën 10% nga ato të parashikuara dhe shpenzimet për materiale të para në masën 20% nga ato të parashikuara. Indikatorin kryesor të performancës së shoqërisë, të ardhurat nga faturimi i ujit, është realizuar në nivele shumë më të ulta nga parashikimi, gjë e cila tregon një performancë jo të kënaqshme (*Trajtuar më hollësisht në faqet 20-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Nga Shoqëria “Ujësjetillës Kanalizime” SH.A Lezhë për vitin 2016 e në vazhdimësi, të bëhet analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxheriale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

-Shoqëria “Ujësjetillës Kanalizime” SH.A Lezhë, të hartojë planin strategjik për zvogëlimin e humbjeve në rrjetin e furnizimit me ujë për periudhën 2017-2020. Ky plan të përmbajë objektiva dhe masa konkrete që duhet të ndërmerren nga shoqëria për eliminimin e humbjeve në rrjet, plan i cili duhet të realizohet deri në fund të vitit 2020.

Në vazhdimësi

4.Gjetje nga auditimi

-Për vitin 2015, “UK Lezhë” SH.A ka një rritje të ndjeshme të shpenzimeve të energjisë elektrike për shkak të rritjes së çmimit të energjisë nga Enti Rregullator i Energjisë me vendimin nr.148, datë 26.12.2014, si dhe nga lidhja e katër kontratave të reja të energjisë elektrike për impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura. Këto shpenzime nuk janë përfshirë në llogaritjen e kostos së prodhimit, si dhe në faturimin e abonentëve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 20-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të kostove operative për të identifikuar mundësitë për rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve. Gjithashtu nëse rezultojnë rritje të pa parashikuara të shpenzimeve (si rritja e çmimit të energjisë) të pasqyrohen në programin ekonomik të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.Gjetje nga auditimi

-Për periudhën objekt auditimi Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, ka filluar procedurat gjyqësore për një numër të konsiderueshëm abonentësh por përsëri, numri i debitorëve dhe vlera e debisë, mbeten në nivele të larta. “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, nuk ka kryer klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve si dhe nuk ka koordinuar punën me sektorët përkatës (Trajtuar më hollësisht në faqet 33-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, të marrë masa për evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të të gjithë debitorëve, duke bashkëpunuar me të gjithë sektorët, me qëllim arkëtimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6.Gjetje nga auditimi:

-Shoqëria, nuk ka miratuar nivelin e pagave nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në kundërshtim me ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja a, ku citohet se organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës (Trajtuar më hollësisht në faqet 28-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i Shoqërisë, të merren masa për miratimin e nivelin të pagave nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në zbatim të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

Në vazhdimësi

7.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi rezulton se, në rregulloren e brendshme dhe në strukturën e miratuar të institucionit, nuk është përcaktuar lloji i arsimimit për të gjitha pozicionet e punës. Gjithashtu nuk është përcaktuar qartë përshkrimi i punës për çdo pozicion. Në rregulloren e brendshme janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e çdo drejtorie. Nuk ka procedurë të qarta lidhur me marrjen në punë të punonjësve, konkurrimin dhe vlerësimin e kandidatëve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Titullari i shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë dhe njësia përgjegjëse për administrimin e Burimeve Njerëzore, të marrin masa që të rishikojnë rregulloren e brendshme të institucionit duke përfshirë në të përshkrimin e procedurave të qarta në lidhje me rekrutimin dhe në procedurat e largimit të punonjësve nga puna, duke rritur transparencën dhe trajtimin e barabartë midis punonjësve apo dhe kandidatëve që rekrutohen. Gjithashtu, të merren masa për rishikimin e strukturës për përcaktimin e llojit të arsimimit për pozicionet e punës dhe për çdo pozicion pune të bëhet përshkrimi i punës në mënyrë që çdo i punësuar të ketë detyra të qarta dhe të mirë përcaktuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi:

-Gjendja debitoare në “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, në datën 31.12.2015, paraqitet në vlerën 290,225,301 lekë. Të ardhurat e pa arkëtuara nga faturimi i ujit të pijshëm, janë në vlerën 263,841,183 lekë. Kësaj gjendjeje debitoare, i shtohen edhe kamatvonesat në zbatim të legjislacionit për operimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm në vlerën 26,384,118 lekë, duke krijuar/shkaktuar **të ardhura të munguara për shoqërinë në shumën totale 290,225,301 lekë.**

-Lidhja dhe ndjekja e kontratës me komunën Kolsh, për furnizimin me shumicë me ujë të pijshëm, është kryer brenda kuadrit ligjor. Nga zbatimi i kësaj kontrate, është krijuar gjendje debitoare, ku nga mos shlyerja e faturave të ujit të pijshëm, ky abonent deri më 30.06.2016 ka një detyrim të pashlyer prej 5,660,975 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për shoqërinë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 33-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i Shoqërisë të merren masa për analizimin e shumës debitoare në vlerën 290,225,301 lekë, në zbatim të legjislacionit për operimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm, si dhe të merret vendimi përkatës për arkëtimin dhe sistemin e kësaj vlere, e cila përbën të ardhur të munguar për shoqërinë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9.Gjetje nga auditimi:

Nga analiza e treguesve të prodhimit, faturimit dhe arkëtimit të ujit, rezulton se për periudhën objekt auditimi, treguesit kanë përmirësim por nuk arrijnë që të mbulojnë koston e prodhimit. Konkretisht:

-Për vitin 2012, “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Lezhë, ka faturuar 1,148,303 m³ ose 90,583,964 lekë nga të cilat janë arkëtuar 67,548,815 lekë ose 74.57% e totalit të faturimit. Humbja në prodhim për këtë vit, është 49,2% ose 1,116,117 m³ shtoj kësaj dhe sasinë e ujit të pa arkëtuar e cila është 25% ose 23,035,149 lekë. Performanca e insitucionit në shitjen dhe arkëtimin e faturave të ujit të pijshëm është në nivelet e 74.57%, nivele performace këto të kënaqshme nisur nga vështirësitë e kësaj shoqërie.

-Për vitin 2013, “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Lezhë, ka faturuar 1,128,035 m³ ose 105,336,422 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 71,694,272 lekë ose 68.06% e totalit të faturimit. Humbja në prodhim për këtë vit, është 48,6% ose 1,070,785 m³, shtoj kësaj dhe sasinë e ujit të pa arkëtuar e cila është 32% ose 33,642,150 lekë. Performanca e insitucionit në shitjen dhe arkëtimin e faturave të ujit të pijshëm, është në nivelet e 68.06%, nivele performace këto 6.5% më të ulta se një vit më pare cka tregon në një përkeqësim të situates financiare dhe menaxhuese të shoqërisë.

-Për vitin 2014, “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Lezhë ka faturuar 1,135,831 m³ ose 122,205,598 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 88,905,102 lekë ose 72.75% e totalit të faturimit. Humbja në prodhim për këtë vit, është 48,4 % ose 1,065,499 m³, shtoj kësaj dhe sasinë e ujit të pa arkëtuar e cila është 27.25% ose 33,300,496 lekë. Performanca e insitucionit në shitjen dhe arkëtimin e faturave të ujit të pijshëm, është në nivelet e 72.75%, nivele performace këto 4.7% më të larta se një vit më pare cka tregon në një përmirësim të lehtë të situatës financiare dhe menaxhuese të shoqërisë.

-Për vitin 2015, “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Lezhë, ka faturuar 1,191,979 m³ ose 129,165,944 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 106,616,225 lekë ose 82.54% e totalit të faturimit. Humbja në prodhim për këtë vit, është 46,5% ose 1,039,519 m³, shtoj kësaj dhe sasinë e ujit të pa arkëtuar e cila është 17.46% ose 22,549,719 lekë Performanca e insitucionit në shitjen dhe arkëtimin e faturave të ujit të pijshëm, është në nivelet e 82.54%, nivele performace këto 9.75% më të larta se një vit më pare cka tregon në një përmirësim të ndjeshëm të situates financiare dhe menaxhuese të shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 33-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-Asambleja e Aksionarëve dhe Këshilli Mbikëqyrës, të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë në arritjen e rezultateve pozitive.

Në vazhdimësi

10.Gjetje nga auditimi:

-Në lidhje me auditimin e kryer mbi dokumentacionin e mbajtur nga komisioni i inventarizimit, në fund të viteve 2012-2015, konstatohet se nuk është bërë numërimi fizik i aktiveve afatgjata edhe pse është plotësuar inventari. Në këtë inventar nuk përmenden specifikimet sipas kartelave të makinerive/pajisjeve/mjeteve, me numërim, matje/peshim, verifikim etiketash/matjesh teknike, etj sipas kërkesave të Udhëzimit nr.30, datë.27.12.2011, i ndryshuar, Kapitulli IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve, pika 73 deri 94 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 57-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-*“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, Dega e Financës, të marrin masa për të kryer inventarizimin e aseteve në mënyrë korrekte duke pasqyruar të gjitha të dhënat e aseteve dhe specifikimet teknike të pajisjeve së bashku me vendndodhjen e saktë të tyre.*

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se në përgjithësi, procedurat e prokurimit, kanë mangësi në dokumentimin mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit ku mungojnë ofertat e marra nga tregu në zbatim të kreut II, pika 2, germa ç, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” nenit 59, ku citohet se: *“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”* (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-*“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, përpara përcaktimit të sasive të nevojshme për prokurim dhe përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, të kryej një analizë të mirëfilltë dhe të gjithanshme për rritjen e efektivitetit, efizienzës dhe ekonomikitetit në mirëadministrimin e fondeve publike si dhe të bëhet dokumentimi i plotë i mënyrës së përlllogaritjes së fondit limit.*

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratave të mallrave dhe shërbimeve, u konstatua se mallrat e ardhur në UK Lezhë SH.A nga një kontratë blerjeje nuk shoqërohen me fletë-hyrje. Gjithashtu, edhe mallrat/makineritë/pajisjet të dërguara për kryerjen e një riparimi jashtë UK Lezhë SH.A nuk janë shoqëruar me fletë-hyrjet/daljet provizore si dhe aktet përkatëse të montimit/çmontimit të tyre në momentin e transportit për tek operatori ekonomik (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, Dega Ekonomike, të marri masa që në të ardhmen të kryejë praktikën e duhura financiare duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm sipas udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, në lidhje me hyrjen dhe daljen e mallrave/makinerive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13.Gjetje nga auditimi:

-Në disa raste, grupet e marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, nuk kanë ndjekur procedurat ligjore për verifikimin e kryerjes së shërbimit por as ato të kolaudimit. Aktet e marrjes në dorëzim të shërbimeve të kryera për elektromotorrët e riparuar, nuk kanë asnjë element teknik tek i cili të pasqyrohet rruga e ndjekur për kryerjen e testimeve sipas standardeve teknike duke vërtetuar kështu cilësinë e shërbimit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, të marrë masa që në të ardhmen, të kryejë procedurat e marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të pajisjeve elektrike të riparuar sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit si dhe të bëhet dokumentimi i tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “Riparim Elektromotorrësh 180 kw - 2 copë, 220 kw - 4 copë dhe Transformator 360 kw - 1 copë” dhe “Riparim Kapital Elektromotorrësh 180 kw me zbarrë, 3-copë”, u konstatua se kërkesat për fillimin e procedurave, janë pa dokumentacion vërtetues për nevojën e kryerjes së riparimeve siç janë parametrat teknikë të pajisjeve pas matjeve të kryera. Ujësjellës Kanalizime Lezhë SH.A nuk ka mbajtur një historik të defekteve të ndodhura tek këto pajisje, nuk ka specifikuar vendndodhjen e saktë të pajisjeve apo makinerive, nuk ka specifikuar sipas kartelave të pajisjeve të dhënat e tyre si rrymat, pesha, ngarkesa elektrike në boshllëk dhe në ngarkesë, funksioni i punës të secilës pajisje etj, duke vështirësuar evidentimin dhe përcaktimin se cila makineri apo pajisje është riparuar apo do të riparohet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, të marri masa që në të ardhmen, përpara fillimit të një procedure prokurimi me objekt riparime ose shërbime të makinerive ose pajisjeve elektrike, të përcaktojë arsyet e kryerjes së shërbimit duke pasqyruar vlerat e parametrave teknik të matur si dhe të specifikojë vendndodhjen dhe funksionin e këtyre pajisjeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i 2 procedurave të prokurimit të anuluar me objekt “Blerje Karburanti D1” viti 2015 me fond limit 4,200,000 lekë pa tvsh dhe “Riparim elektromotorësh 180 kw 2 copë, 220 kw 4 copë dhe trasformatorë 360 kw 1 copë” viti 2012 me fond limit 2,244,000 lekë, u konstatua se Autoriteti Kontraktor, nuk ka analizuar shkaqet e anulimit, nuk ka nxjerrë arsyet dhe nuk ka marrë masat për përmirësimin e dokumentave të tenderit duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësullës Kanalizime” SH.A Lezhë, të marri masa që në të ardhmen, për procedurat e prokurimit të anuluar, të konkludojë me korrektësi dhe rigorozitet në respektim të ligjit për të pasqyruar dhe argumentuar shkaqet e anulimit të tyre, të cilat duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe t’u komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në tender, duke reflektuar ndryshimet përkatëse në Dokumentet standarde të tenderit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16.Gjetje nga auditimi:

-Në dy procedura tenderimi “Blerje karburant naftë D1” për vitet 2013 dhe 2014, KVO ka kualifikuar operatorë ekonomik me mangësi në dokumentacionin e dorëzuar krahasuar me dokumentacionin e kërkuar sipas dokumentave standarde të tenderit edhe pse oferta e dhënë, është më e ulta, veprim në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, pika 4 si dhe dokumentave standarde të tenderit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësullës Kanalizime” SH.A Lezhë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrin masa që në të ardhmen të kualifikojnë operatorët ekonomikët të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, në respektim të dispozitave ligjore për prokurimin publik.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

17.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Hipoklorit Kalciumi për UKL SH.A” viti 2012, u konstatua se njësia e prokurimit, për përcaktimin e vlerës së fondit limit, referuar testimit të tregut, nuk ka paraqitur dokumentacion vërtetues të ofertave të marra, vlerë e cila është rritur me 182,440 lekë krahasuar me kontratën e mëparshme duke sjellë efekt financiar negativ për buxhetin e

shoqërisë UK Lezhë SH.A., (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, Njësia e Prokurimit, të marri masa, që në të ardhmen, për përcaktimin e fondit limit, të dokumentojë mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar çmimeve të INSTAT, kontratave të mëparshme dhe/ose studimit të tregut.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

18.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i pagesave të bëra nëpërmjet bankës për blerjet e vogla, rezultoi se disa pagesa, janë kryer pa plotësuar praktikën me dokumentacionin justifikues, si kopjen e fletëhyrjes dhe aktin e marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku përcaktohen rregullat për kryerjen e pagesave (Trajtuar më hollësisht në faqet 115-132, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, Dega Ekonomike, të marrë masa, që të gjitha dokumentet për hyrjet dhe daljet nga magazina, të plotësohen sipas rubrikave përkatëse në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

19.Gjetje nga auditimi:

-Në “Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, në rregulloren e brendshme, nuk janë implementuar procedurat në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik GMS, në funksion të objektivave të institucionit dhe sipas ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (Trajtuar më hollësisht në faqet 133-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, të marrë masa që në rregulloren e brendshme, të implementojë sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat, si dhe të hartojë plan-veprimet afatshkurtra për zbatimin e ligjit nr.10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2012 deri 30.06.2016, “Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, ka realizuar 11 procedura prokurimi me vlera të larta në shumën totale prej 37,293,444 lekë me tvsh., nga auditimi i të cilave, u konstatua se dëmi ekonomik i shkaktuar, është në vlerën 712,890 lekë.

1.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Punime Riparimi dhe Lyerje Zyra U.K Lezhë & Stacione Pompimi 2 dhe 3 Barbullojë & Stacioni i ujrave të zeza Lezhë” viti 2015 u konstatuan:

-Zëra punimesh të pa kryera nga operatori ekonomik “██████████” sh.p.k si zbatues i kontratës, në shumën **324,451 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “UK Lezhë” SH.A.,** (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **324,451 lekë, si vlerë që i përket punimeve të pa kryera nga operatori ekonomik “██████████” sh.p.k, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “UK Lezhë” SH.A.**

Brenda datës 31.12.2016

2. Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Hipoklorit Kalciumi për UKL SH.A” viti 2012, u konstatuan vonesa në afatet e ekzekutimit të kontratës. Bazuar në kushtet e kontratës dhe afatet e lëvrimit të mallit, rezulton se dorëzimi i mallit është kryer me 14 ditë vonesë. Si rrjedhojë, operatorit ekonomik “██████” sh.p.k, duhet t’i mbahej penaltetit prej $(2,851,200 * 4/1000 * 14ditë) = 159,656 \text{ lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “UK Lezhë” SH.A.,}$ (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjetllës Kanalizime” SH.A Lezhë, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **159,656 lekë nga operatori ekonomik “██████” sh.p.k , si penaltet për mos përmbushje të afateve të ekzekutimit të kontratës me objekt “Blerje Hipoklorit Kalciumi për UKL SH.A” viti 2012.**

Brenda datës 31.12.2016

3.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i likuidimit të faturave mujore të dorëzuara nga operatori ekonomik “██████████” SH.A për furnizimin e UKL SH.A me lëndë djegëse naftë

D1, u konstatuan përlllogaritje të gabuara jo sipas formulës {**çmim burse** * densitet * kursi i këmbimit + (taksë karboni + taksë qarkullimi + akcizë)}+ **marzhin e fitimit** = çmimin për litër * litra të furnizuara = vlera e faturës. Diferencat e likujduara më tepër ndaj operatorit ekonomik janë në shumën **117,538 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për “UK Lezhë” SH.A.,** (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **117,538 lekë** nga operatori ekonomik “██████████” SH.A, si vlerë e përfituar padrejtësisht nga likuidimet e faturave mujore.

Brenda datës 31.12.2016

4.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit me objekt “Riparim Elektromotorrësh 180 kw - 2 copë, 220 kw - 4 copë dhe Transformator 360 kw - 1 copë” viti 2012 dhe “Riparim Kapital Elektromotorrësh 180 kw me z barrë, 3-copë” viti 2013, u konstatuan vonesa në afatet e ekzekutimit të kontratave të lidhura dhe konkretisht:

-Ekzekutimi i kontratës me objekt “Riparim Elektromotorrësh 180 kw - 2 copë, 220 kw - 4 copë dhe Transformator 360 kw - 1 copë” viti 2012, ka përfunduar 20 ditë me vonesë. Si rrjedhojë operatorit ekonomik “██████████” SH.A, duhet t’i mbahej penalteti prej $2,592,000 \times 0.05\% \times 20 \text{ ditë} = \mathbf{25.920 \text{ lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “UKLezhë” SH.A.}$

-Ekzekutimi i kontratës me objekt “Riparim Kapital Elektromotorrësh 180 kw me z barrë, 3-copë” viti 2013, ka përfunduar 53 ditë me vonesë. Si rrjedhojë, operatorit ekonomik “██████████” SH.A, duhet t’i mbahej penalteti prej $1,260,000 \times 0.05\% \times 53 \text{ ditë} = \mathbf{33,390 \text{ lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “UK Lezhë” SH.A}$ (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës **59,310 lekë** nga operatori ekonomik “██████████” SH.A, si penaltet për mos përmbushje të afateve të ekzekutimit të kontratave me objekt “Riparim Elektromotorrësh 180 kw - 2 copë, 220 kw - 4 copë dhe Transformator 360 kw - 1 copë” viti 2012 dhe “Riparim Kapital Elektromotorrësh 180 kw me z barrë, 3-copë” viti 2013.

Brenda datës 31.12.2016

5.Gjetje nga auditimi:-Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Hipoklorit Kalciumi për UKL SH.A” viti 2014, u konstatuan vonesa në afatet e ekzekutimit të kontratës. Bazuar në kushtet e kontratës dhe

afatet e lëvrimit të mallit, rezulton se dorëzimi i mallit, është kryer me 7 ditë vonesë. Si rrjedhojë, operatorit ekonomik “█” sh.p.k, duhet t’i mbahej penaliteti prej $(1,920,000 * 4/1000 * 7\text{ditë}) = 53,760 \text{ lekë}$, **vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë “UK Lezhë” SH.A** (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më lart rekomandojmë:

-“Ujësjellës Kanalizime” SH.A Lezhë, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës 53,760 lekë nga operatori ekonomik “█” sh.p.k , si penalitet për mos përmbushje të afateve të ekzekutimit të kontratës me objekt “Blerje Hipoklorit Kalciumi për UKL SH.A” viti 2014.

Brenda datës 31.12.2016

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës, neni 15, i kërkojmë Drejtorit të Shoqërisë “UK Lezhë” SH.A., që në mbështetje të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

-“Vërejtje”

1. **EM**, me detyrë, anëtar i njësisë së prokurimit.

2. **PB**, me detyrë, anëtar i njësisë së prokurimit dhe hartues i specifikimeve teknike.

Për arsye se;

-Në procedurat e prokurimit, në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk kanë argumentuar me dokumenta ligjore, mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me VKM nr.1, datë.10.01.2007, Për rregullat e prokurimit publik, e ndryshuar, Kreun V, Zhvillimi i procedurave, pika 1, gërma c, ku citohet: “Përveç detyrave të përcaktuara në këto rregulla ose të detyrave të tjera, që i ngarkohen, njësia e prokurimit është përgjegjëse për sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike, të regjistrit të realizimit, për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për botim, brenda afateve kohore, për hartimin e urdhrave të prokurimit, **për mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen dokumenteve të tenderit (si për shembull, hartat, skicat, planet, etj), për mirëmbajtjen e regjistrit zyrtar të zbatimit të procedurave, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, si dhe për llogaritjen e çmimeve të shitjes**” (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Për anulimin e procedurave të prokurimit dhe fillimin e procedurave të reja, nuk ka bërë asnjë analizë të shkaqeve të anulimit duke vepruar në kundërshtim

me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”.

-Për hartimin e specifikimeve teknike jo të qarta për riparimin e pajisjeve duke mos ju referuar parametrave teknik të pajisjeve në pronësi të “UK Lezhë” SH.A, dhe për përcaktimin e sasive të mallrave, duke mos iu referuar sasive të mallrave të konsumuar në vitet paraardhëse në kundërshtim me ligjin nr.9463, datë.20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”, neni.23, specifikimet teknike (Trajtuar më hollësisht në faqet 66-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. M Gj, me detyrë, përgjegjëse e sektorit të shitjes së ujit të pijshëm.

4. S Sh, me detyrë, përgjegjës i sektorit të vjeljes së të ardhurave.

Për arsye se;

-Për periudhën objekt auditimi, gjendja debitore në datën 31.12.2015, nga mos arkëtimi i faturave të ujit të pijshëm, është në masën 263,841,183 lekë. Kësaj gjendjeje debitore, i shtohen edhe kamatvonesat në shumën 26,384,118 lekë në zbatim të legjislacionit për operimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm duke krijuar/shkaktuar **të ardhura të munguara për shoqërinë në vlerën totale 290,225,301 lekë**, në zbatim të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996, i ndryshuar “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, ku çdo konsumatori i lind detyrimi për shlyerjen e faturave të ujit të pijshëm në zbatim të pikës 4.4 (1) **Mospagimi për konsumin e ujit të pijshëm** si dhe pikës 4.5.2 (2) **Ndërprerja e furnizimit me ujë**, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8975 datë 21.11.2002 ”Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv” (Trajtuar më hollësisht në faqet 33-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D. TË TJERA

Ky auditim është vlerësuar shumë dobët nga Kryetari i KLSH-së.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R